

VENDIM
Nr. 219, datë 4.7.2023

MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK I ERËS “DROPULLI WIND”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1069/9 prot., datë 30.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘Eu Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës ‘Dropulli Wind’, me kapacitet të instaluar 20 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 158, datë 5.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik “Dropulli Wind” me kapacitet të instaluar 20 mw, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, qarku Gjirokastrë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.5.2023 dhe 8.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 4.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1069/7 prot., datë 15.5.2023, ERE i është drejtuar shoqërive “Eu Green Energy” sh.p.k., “Winpharma” sh.p.k. dhe “A.91” sh.p.k., të cilat kanë krijuar bashkimin e përkoshëm për të cilin MIE ka dhënë dhe Autorizimin Paraprak me nr. 469/5, datë 7.12.2021, për ndërtimin e impiantit eolik 20 mw, në Dropull, Gjirokastrë, në lidhje me zhvillimin e një seance dëgjimore me qëllim përcaktimin e shoqërisë që do të mbajë licencën për këtë impiant e po ashtu për të sqaruar pjesën tjetër të dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 5.6.2023 dhe pas sqarimeve të dhëna në këtë seancë shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271/3 prot., datë 6.5.2023.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën nr. 1271/7 prot., datë 20.6.2023, ERE i evidentoi shoqërisë dokumentacionin që mbetej ende pa u plotësuar në këtë aplikim.

- Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 5.6.2023 në ERE, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është deklaruar se i vetmi dokument që ka mbetur për të plotësuar dosjen përkatëse për të vijuar me VKM-në dhe vendimin final të MIE-s për këtë projekt është përfundimi i procedurave për të lidhur kontratën e qirasë për të gjithë sipërfaqen e që shtrihet projekti, gjë që kushtëzohet nga konstituimi i Këshillit të ri Bashkiak të Bashkisë Dropull, për këtë arsye për të plotësuar të gjithë dosjen e aplikimit në ERE mund të nevojitet dhe zgjatje e vendimarrjes finale për licencim.

- Për sa më sipër dhe me qëllim për t’i dhënë mundësinë shoqërisë që të depozitojë në ERE dokumentacionin thelbësor të këtij aplikimi, i cili nuk varet vetëm nga përpjekjet e shoqërisë, vlerësohet të pezullohet vendimarrja e Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 mw.

- Në nenin 14, pika 10, e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e

ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen për aplikimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik “Dropulli Wind” me kapacitet të instaluar 20 mw, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, qarku Gjirokastrë, deri s shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin si më poshtë vijon:

- aktin përkatës mbi dhënien e dakordësisë për shoqërinë kryesuese të Bashkimit të Përkohshëm (të shoqërive “Eu Green Energy” shpk, “Winpharma” shpk dhe “A.91” shpk) e cila do të marrë dhe licencën nga ERE dhe do të operojë centralin) duhet t’i referohet parkut eolik 20 mw;

- VKM-në përkatëse dhe kontratën e nënshkruar me MIE-n për ndërtimin e parkut eolik “Dropulli Wind”, me kapacitet 20 mw,;

- përcaktimin e mënyrës së financimit të projektit dhe depozitimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare referuar mënyrës së financimit;

- saktësimin e numrit të njërive gjeneruese (agregatëve eolikë), në referencë të kapacitetit total të parkut eolik (20 mw);

- miratimin përfundimtar të OST sh.a. për pikën e lidhjes me rrjetin.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti